



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON:
PRIMEJENË:

08/07/2024,
05/359

Komuna e Malishevë
Opstina / Municipality of Malishevë
Drejtoria për Urbanizëm

Nr.No.Br.

Data: 07.08.2024

Numri i vrojtimit i lejes: 05/359

Drejtoria për Urbanizëm e Komunës së Malishevës në bazë të nenit 14,15,18,19,20 dhe 21 të Ligjit të Ndërtimit, nr. 04/L-110 dhe Ligjit për Planifikim Hapësinor me Nr. 04/L-174 të datës: 31.07.2013, nenit,1,2 pika 1,1 dhe 1.2 nenit 21,22 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 të datës: 21.06.2016, Neni 17, pika “d” të ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, të datës. 20.02.2008, Udhëzimit Administrativ mbi Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor me nr. 08/2017 të datës: 09.06.2017, Udhëzimit Administrativ për kategorizimin e ndërtimeve me nr. 04/2017, nenit 14,16,17,21,22 të Udhëzimit Administrativ për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për Kushte ndërtimore, Leje ndërtimore dhe Leje rrërimi për kategorinë I dhe të II-të të ndërtimeve me nr. 06/2017 të datës: 23.05.2017, Rregullores Nr. 03/2016 për Normat Minimale Teknike për Ndërtesat e banimit në Bashkëpronësi të datës: 04.11.2016, dhe Planit Zhvillimor Komunal 2019-2027 të Komunës së Malishevës duke vendosur sipas kërkesës nr. 05/359 të datës: 07.08.2024 të aplikuesit “Drejtoria për Arsim dhe Edukim” me seli në Malishevë, për lejimin e ndërtimit të objektit të Institucionit Parashkollor – Çerdhja e fëmijëve në fshatin Bellanicë, me etazhitet P+1, ZK Bellanicë, Drejtoria për Urbanizëm në procedurë të rregullt administrative pas shqyrtimit të lëndës lëshon këtë:

VENDIM PËR LEJE NDËRTIMORE

I.

Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	DREJTORIA PËR ARSIM DHE EDUKIM		
Adresa:	Rr. “Gjergj Kastrioti Skenderbeu”, pn, në Malishevë		
Telefoni:		Emaili:	

II.

Emri i Projektit:	ÇERDHJA E FËMIJËVE NË FSHATIN BELLANICË; P+1		
Emri i Projektuesit:	Studio Projektuese: ENGGROUP SH.P.K		
Adresa:	Rruga “Nebih Gashi”, Bll B6.Ob 2.K-1. 10000 Prishtinë, Kosovë		
Telefoni:	044 270 7446	Emaili:	



III.

Për punët ndërtimore në vijim:		
Adresa: Rrgua Ismail Qemali, Bellanicë, Malishevë		
Zona(t) Kadastrale: Bellanicë	Nr. I parcelës kadastrale: 2861-0	GPS Koordinatat:
Lloji i ndërtimit të propozuar:		
Ndërtimi i ri: ☒	Rindërtim: ☐	Riparim: ☐
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:		
Kategoria I: ☒	Kategoria II: ☐	
Përdorimi i propozuar: Institucion Parashkollor	A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po: ☐ Jo: ☒	
Përshkrimi: Objekti Institucionit Parashkollor – Çerdhja e fëmijëve në fshatin Bellanicë me etazhitet P+1 Bazuar në dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, të prezantuar dhe miratuar nga kjo drejtori, sipërfaqja e tërësishme bruto ndërtimore e objektit të banimit individual me etazhitet P+1: Sipërfaqja mbitokësore e tërësishme e lejuar për ndërtim është S=886.36 m² , me nivele ndërtimore dhe me kuota të nivelit të dyshemesë së përdhësës, si dhe lartësi deri në dyshemenë e katit të fundit dhe kulmit, për objektin si në vijim: Institucioni Parashkollor me 2 nivele ndërtimore, me kuotë relative të nivelit të dyshemesë së përdhësës +0.00 m, dyshemesë së katit 1 +3.30 m, dhe katit të fundit + 6.6 m, dhe Destinimi, nivelet me kuota relative, përmbajtja dhe sipërfaqet e ndërtesave, janë: Përdhesa (0.00 m) me sipërfaqe prej 533.3 m² , me destinim dhe përmbajtje: hapësira komunikuese (shkallë, ashensor dhe koridore) dhe hapësirat përciellëse të çerdhës. Kati 1 (+3.30 m) me sipërfaqe prej 353.06 m² ; me destinim dhe përmbajtje: hapësira komunikuese (shkallë, ashensor dhe koridore) dhe hapësirat përciellëse të çerdhës.		

IV. Me këtë leje ndërtimore lejohet vendosja/ndërtimi i ndërtesave ndihmëse/montazhe, të planifikuara sipas elaboratit për organizimin e vendndërtimit, për nevoja të kompanisë ekzekutuese dhe mbikëqyrës të ndërtimit, në afatin kohor deri në momentin e realizimit të ndërtimit.

V. Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Të vendos tabelën informuese në vend ndërtim me informatat e mëposhtme:
 - informata mbi Lejen Ndërtimore
 - informata mbi projektuesin
 - informata mbi kontraktuesin
 - prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vend ndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;

- një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
- projektin kryesor me të gjitha fazat për nevojat e realizimit të ndërtimit;
- dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
- librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
- protokollet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
- Të dorëzoj njoftim inspektoriatit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
- Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
- Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftoj organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

Arsyetim

Aplikuesit Drejtoria për Arsim dhe Edukim me seli në Malishevë, me kërkesën nr.05/359 të datës: 07.08.2024 ka kërkuar nga Drejtoria për Urbanizëm lëshimin e Lejes Ndërtimore për objektin: Institucioni Parashkollor me etazhitet P+1, kategoria I e ndërtimit, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të këtij vendimi.

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore Drejtoria për Arsim dhe Edukim me seli në Malishevë i lejohet ndërtimi i Objektit të Institucionit Parashkollor me etazhitet P+1 kategoria I e ndërtimit, në ngastrën kadastrale Nr. **P-72316002-02861-0**, Zona Kadastrale Bellanicë me sipërfaqe totale prej **14504 m²** e drejta pronësore juridike e P.SH. SHKOLLA FILLORE ISMAIL QEMAJLI në bazë të Certifikatës së Pronësisë 1322-2024 të datës: 06.08.2024 dhe Kopjes të Planit të datës: 06.08.2024.

Drejtoria e Urbanizmit, duke u bazuar në përmbajtjen e dokumentacionit në dosjen e kërkesës/lëndës me nr. 05/359 të datës: 07.08.2024, konstatoi se është prezantuar dhe trajtuar dokumentacioni i mëposhtëm:

- Shtojca Nr.2 Kërkesë për Leje Ndërtimore për Kategorinë e I-rë.
- Parcela kadastrale me Nr. P-72316002-02861-0, Zona Kadastrale Bellanicë me sipërfaqe totale prej 14504 m² e drejta pronësore juridike e P.SH. SHKOLLA FILLORE ISMAIL QEMAJLI në bazë të Certifikatës së Pronësisë 1322-2024 të datës: 06.08.2024 dhe Kopjes të Planit të datës: 06.08.2024.

- **VENDIM PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E ÇERDHËS PUBLIKE NË FSHATIN BELLANICË KOMUNA E MALISHEVËS: 02/147 të datës: 22.03.2024**
- Tri kopje të dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor të ndërtësës së planifikuar, në kopje të fortë/fizike dhe një kopje digjitale CD, të hartuar nga kompania projektuese “ENGGROUP” SH.P.K me seli në Prishtinë, me certifikat të regjistrimit të biznesit nr.810502759.
- Arkitektura “ENGGROUP” SH.P.K
- Struktura “ENGGROUP” SH.P.K
- Hidroinstalimet “ENGGROUP” SH.P.K
- Elektriika “ENGGROUP” SH.P.K
- Makineria “ENGGROUP” SH.P.K

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjin Nr.02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitave tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për **lëshimin e Lejes Ndërtimore**, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vërejte: Çdo ndryshim i projektit nga kushtet e aprovuara nga drejtoria e Urbanizmit është përgjegjësi e investitorit dhe kompanisë projektuese.

Nga një kopje të vendimit t’i dërgohet:

- 1.Parashtruesit të kërkesës
- 2.Inspeksionit
- 3.Kësaj Drejtorie

PUNOI:


Msc. Ark. Lulzim Mazreku

DREJTOR/DREJTORISË


Avdi Morina